



# KONCEPT

## për transformimin digjital të shoqërisë

### 1. Parime

#### Parime politike

- Sundimi i së drejtës: Menaxhimi dhe përdorimi i sistemeve të TIK për grumbullimin, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave ka bazë ligjore. Rregullat dhe rregulloret mbështesin parimet e një tregu të lirë, të drejtë konkurrencës dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive.
- Kohezioni social dhe partneriteti publik privat: Transformimi digjital arrihet nga bashkëpunimin ndërmjet qeverisë, institucioneve publike, kompanive private, shoqërisë civile dhe komunitetit akademik.

#### Qasje e lirë në informacionet publike

- Çdokush mund të qaset lirshëm dhe të përpunojë të dhënat e krijuara nga puna e administratës publike (të dhënat publike).
- Mund të kufizohet me procedura ligjore qasje në të dhëna të caktuara publike (të dhëna personale dhe informacionet e klasifikuara). Të gjitha kufizimet në qasje në të dhënat publike mund të kundërshtohen në gjykatë.
- Çdo institucion publik ka një faqe interneti të hapur përmes të cilës mund të kërkohet dhe të qaset lehtësisht në të gjitha të dhënat dhe dokumentet publike.
- Gazeta Zyrtare është një sistem informimi që integron procesin e miratimit të ligjeve që nga fillimi i krijimit të tyre e deri te miratimi dhe publikimi i tyre. Sistemi është i hapur dhe ofron qasje falas në të gjitha rregulloret ekzistuese 24/7

#### Burime të besueshme të të dhënave

- Burime legjitime dhe të besueshme të të dhënave janë bazat e të dhënave të shtetit edhe atë
  - Regjistri i të dhënave të qytetarëve;
  - Regjistri i personave juridikë;
  - Regjistri i patundshmërive.
- Shteti garanton besueshmërinë e të dhënave në këto regjistra dhe është përgjegjës për çdo dëmtim të shkaktuar nga të dhëna të pasakta.

#### Digjitalja është standarde

- Në rast konflikti ndërmjet të dhënave digjitale në bazat e të dhënave që janë burime të besueshme të dhëna dhe dokumente në letër, versioni digjital ka përparësi
- Nënshkrimi digjital i krijuar me letërnjoftim është ekuivalente me një nënshkrim të shkruar me dorë. Në rast se konflikti mes digjitalit dhe nënshkrimit me dorë, versioni digjital ka përparësi.
- Të dyja parimet kanë bazë ligjore.

#### Parimi “Vetëm një herë”

- Të dhënat që vendosen një herë në regjistrin publik, nuk mund që përsëri të kërkohen nga personat fizik dhe juridik.
- Është e ndaluar nga kushdo të kërkohet të parashtrijë dokumente në letër, nëse të dhënat tashmë ekzistojnë në bazat e të dhënave digjitale të burimeve të besueshme të të dhënave.



## 2. Zbatimi

### Ndërlidhja

- Shteti e rregullon tregun telekomunikues, i cili është i lirë dhe i hapur për konkurrencë.
- Të gjitha licencat lëshohen përmes konkursit të hapur me procedura transparente.
- Qeveria siguron një mjedis për shkëmbim të sigurt të të dhënave (platformë për ndërveprueshmëri).
- Qeveria do të sigurojë masa për mbështetje për ndërlidhjen e të gjitha amvisërive të shërbimeve me brez të gjerë në 5 vitet e ardhshme

### Letërnjoftim elektronik

- Të gjithë banorët kanë numër të vetëm personal identifikues (Numri i Vetëm Amë i Qytetarit)
- Letërnjoftimi elektronik lëshohet për çdo qytetar.
- Letërnjoftimi elektronik mundëson vërtetim dhe nënshkrim digjital të dokumenteve në mënyrë të sigurt.
- Qeveria në bashkëpunim me sektorin privat në mënyrë aktive e zhvillon dhe e promovon përdorimin e letërnjoftimit elektronik për shërbime elektronike.

### Agjencia për digjitalizim

- Për t'u arritur qëllimet e vendosura me Konceptin dhe për t'u ndjekur Udhërrëfyesi për Transformim Digjital, do të formohet Agjenci për Digjitalizim, me kompetenca:
- Koordinim i aktiviteteve (përfshirë grumbullimet, përpunimin dhe grumbullimin e të dhënave) mes të gjitha institucioneve qeveritare;
  - Koordinim për përgatitjen e ligjeve;
  - Menaxhim me ambientin për shkëmbim të sigurt të të dhënave
  - Vendosje e standardit për TIK dhe siguri kibernetike për të gjitha palët e interesuara;
  - Dhënie e drejtimeve të përgjithshme për menaxhim me ndryshime gjatë transformimit digjital dhe ngritjes të vetëdijes publike.

### Aktivitete të decentralizuara

- Sigurim i shërbimeve publike dhe udhëheqje elektronike regjistrave është detyrë e çdo institucioni publik. Kjo mund të bëhet edhe me bashkëpunimin horizontal ndërmjet institucioneve
- Siguria kibernetike e TIK-ut sistemet e institucioneve sigurohen duke monitoruar standardet e miratuara në mënyrë qendrore
- Nuk do të vendosen superbazat qendrore të të dhënave. Administrata publike vepron nëpërmjet shkëmbimit të të dhënave ndërmjet institucioneve që e përdorin atë mjedis të sigurt të shkëmbimit të të dhënave.
- Ngritja e ndërgjegjësimit publik dhe të kuptuarit e përfitimeve nga digjitalizimi për të gjitha palët e interesuara në shoqëri.

### Aktivitete të centralizuara

- Mjedis i sigurt për shkëmbimin e të dhënave.
- Lëshim i letërnjoftimit elektronik. Standardizim.
- Licencim i aktiviteteve telekomunikuese që shfrytëzojnë burime të kufizuara natyrore.
- Siguri kibernetike e rrjeteve nacionale, baza themelore të të dhënave dhe letërnjoftim elektronik.
- Bashkëpunim mes institucionet.- Projekte për ngritjen e vetëdijes publike dhe njohjes digjitale – menaxhim i përgjithshëm me ndryshimet.

### Zbatim i konceptit

- Miratim i konceptit me vendim të Qeverisë.
- Përpunim i Udhërrëfyesit për zbatim, në të cilin janë theksuar hapat më të rëndësishëm për ekzekutimin e konceptit.
- Koncepti do të realizohet përmes planeve, strategjive dhe nismave ligjore të bazuara në konceptin, ndërsa të cilat e ndjekin kornizën kohore të Udhërrëfyesit.